



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj



DEMOCRACY
PLUS

Instituti hulumtues Demokraci për Zhvillim
Seria: Zgjedhjet dhe partitë politike | Nr. 13 | Prishtina, 2018 |

VOTIMI NGA JASHTË VENDIT

Shqyrtimi i politikave dhe rekomandime praktike


PRISHTINË, TETOR, 2018



VOTIMI NGA JASHTË VENDIT

Shqyrtimi i politikave dhe
rekomandime praktike

PRISHTINË, TETOR, 2018



Të drejtat e autorit © 2018. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) dhe Demokraci Plus (D+)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, Institutit Demokraci për Zhvillim apo Demokraci Plus.

Punimi u përpilua nga:

Demokraci për zhvillim (D4D)

Demokraci Plus (D+)

Përpiluar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) dhe Demokraci Plus (D+), dhe mbështetur nga Departamenti Federal i Zvicres për Punë të Jashtme dhe me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP)¹ – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Pëmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim (D4D) dhe Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Departamentit Federal për Punë të Jashtme të Zvicrës , SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
I.Votimi nga jashtë në Kosovë	9
Pse votimi jashtë vendit?	9
Diaspora në Kosovë.....	10
Korniza ligjore mbi votimin jashtë Kosovës	10
Procedurat për votimi nga jashtë.....	12
Pjesëmarrja e diasporës në procesin zgjedhore në Kosovë	12
Pengesat në pjesëmarrjen e diasporës në zgjedhje.....	16
II.Votimi jashtë vendit: Analiza krahasimore	19
Lloji i zgjedhjeve për të cilat lejohet votimi nga jashtë.....	19
Mënyra e votimit	21
Mënyra e përfaqësimit	22
Kriteret për të drejtën e votimit jashtë vendit	24
III.Konsultimet për votim nga jashtë vendit për Kosovë	26
IV.Rekomandimet për votim jashtë Kosovës	27
Rekomandimet e zbatueshme me kornizën ligjore aktuale	27
Rekomandimet e zbatueshme me ndryshime ligjore.....	29
V.Instrumentet ndërkombëtare mbi votimin jashtë vendit	30



**Votimi nga jashtë është i lejuar me
legjislacion në 151 vende.**

(International IDEA)

HYRJE

Instrumentet ndërkombëtare ligjore nuk i obligojnë shtetet që të organizojnë votim për qytetarët jashtë vendit dhe është në diskrecion të secilit vend që të zgjedh nëse dëshiron të organizojë votimin nga jashtë. Përgjithësisht, votimi jashtë vendit konsiderohet një proces i vështirë dhe sfidues dhe nëse shtetet vendosin ta organizojnë, pritet që ky proces t'i përmbush standardet e njëjta sikurse votimi brenda shtetit, në kuptim të transparencës, sigurisë dhe ruajtjes së fshehtësisë së votës.

Në Kosovë votimi jashtë vendit është i lejuar për të gjitha llojet e zgjedhjeve. Votuesit mund të votojnë përmes postës nëse kanë aplikuar në mënyrë të suksesshme në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Edhe pse ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, pjesëmarrja e tyre në zgjedhje në Kosovë deri më tani ka qenë shumë e ulët, gjë që duhet të ndryshojë.

Ky hulumtim ka për qëllim që të kontribuojë në rritjen e pjesëmarrjes së diasporës në proceset zgjedhore në Kosovë përmes shqyrtimit të praktikave të votimit jashtë vendit në shtetet e tjera, studimit të barrierave të diasporës për të votuar dhe vendosjes së politikave efektive për të lehtësuar votimin nga jashtë. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) bashkë me Demokraci Plus (D+) kanë hartuar këtë raport për të paraqitur gjendjen e tanishme dhe për të analizuar dilemat e politikave dhe rezultatet që mund të rezultojnë nga vendime të ndryshme. Për këtë dokument janë mbajtur konsultime publike edhe me përfaqësues të diasporës.

Kjo inicativë ka filluar së pari në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporën që në vitin 2015, si përpjekje e Ministrisë për të përmirësuar procesin e politik-bërjes në Kosovë. Duke pas parasysh ngritjen e interesimit për votimin nga jashtë në zgjedhjet e vitit 2017 dhe problemet e hasura me votimit nga jashtë, është vlerësuar e nevojshme që të përditësohet dhe plotësohet raporti, duke pas parasysh gjithashtu shënimet nga konsultimet publike që janë mbajtur me pjesëtar të diasporës gjatë verës së vitit 2018.

Pjesa e parë e punimit ku analizohet korniza ligjore në Kosovë për votim jashtë vendit dhe analiza krahasimore me vende tjera bashkë me instrumentet ndërkombëtare, është e përpiluar nga D4D, ndërsa konsultimet në fokus grupe me akterë vendorë dhe diasporë, janë realizuar nga D+.

Hulumtimi fillimisht analizon kontekstin e votimit jashtë vendit në Kosovë, kornizën ligjore, mënyrën dhe procedurat aktuale të votimit jashtë Kosovës. Më tej, hulumtimi përmban analizë krahasimore me shtetet e tjera si dhe jep rekomandime për ndjekjen e politikave efektive për lehtësimin e votimit. Në fund, si shtojcë e këtij raporti, janë prezantuar standardet dhe parimet ndërkombëtare që rrjedhin nga instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe instrumente të tjera këshilluese.

PJESA KRYESORE E KËTIJ RAPORTI ËSHTË ANALIZA KRAHASIMORE ME SHTETET E TJERA, KU JANË SHQYRTUAR KATËR (4) ÇËSHTJE KRYESORE NË LIDHJE ME PRAKTIKAT PËR VOTIM JASHTË VENDIT:

- 1 Llojet e zgjedhjeve për të cilat lejohet votimi;
- 2 Metodatat që mund të përdoren për votim;
- 3 Mënyrat e përfaqësimit të qytetarëve jashtë vendit;
- 4 Kriteret e zotësisë juridike për të votuar.

Shtetet që kanë qenë pikë studimi gjatë analizës krahasimore janë zgjedhur për shkak të një apo më shumë arsyeve si në vijim: (a) janë shtete fqinje në rajon; (b) janë shtete që kanë ngjashmëri socio-politike me Kosovën; (c) aplikojnë mekanizma për përfaqë-

sim të diasporës, ose (d) përdorin metoda efektive dhe inovative për zbatimin e votimit jashtë vendit. Studimi i praktikave të këtyre shteteve ka mundësuar që të identifikojmë metoda dhe procedura që mund të aplikohen edhe në Kosovë.

I. VOTIMI NGA JASHTË NË KOSOVË

Pse votimi jashtë vendit?


Si rezultat i globalizimit, konflikteve dhe migrimit, shumë shtete kanë një numër të madh të qytetarëve që jetojnë jashtë territorit të tyre - që zakonisht njihen si diasporë. Këto shtete dallojnë në qasjen e tyre ndaj qytetarëve jashtë vendit dhe mënyrës se si i inkuadrojnë diasporën në jetën ekonomike dhe politike të vendit. Kohëve të fundit janë rritur kërkesat që shtetet të marrin masa për t'ua mundësuar qytetarëve jashtë vendit të gëzojnë të drejtat e tyre politike, përfshirë të drejtën për të marrë pjesë në proceset zgjedhore të vendlindjes së tyre.

Votimi jashtë vendit mund të ketë ndikim substancial në rezultatet e zgjedhjeve dhe si pasojë në jetën politike brenda shtetit, veçanërisht kur një shtet ka diasporë të madhe në proporcion me popullsinë brenda vendit – siç është edhe rasti i Kosovës. Përderisa dikush mund të argumentojë se votimi nga diaspora ua mundëson votimin të gjithë qytetarëve dhe mirëmban lidhjet e shtetit me qytetarët jashtë vendit, disa të tjerë argumentojnë se qytetarët jashtë vendit nuk duhet të lejohen të votojnë, pasi që ata nuk paguajnë taksa dhe janë më pak të prekur drejtpërsëdrejti nga veprimet e zyrtarëve qeverisës ose ligjvënës. Më poshtë është një përmbledhje e argumenteve të njohura për dhe kundër votimit jashtë vendit, të kontekstualizuara për Kosovë:

PËR



- Mundëson që të gjithë qytetarët të votojnë, dhe ofron mundësi të barabarta votimi për të gjithë;
- Njeh qytetarët jashtë vendi si persona juridik bazuar në kombësinë e tyre;
- Mundëson qytetarëve që jetojnë jashtë shtetit pjesëmarrjen në zhvillimet politike në vendlindje;
- Siguron që qytetarët të mbajnë lidhje me prejardhjen e tyre;
- Rrit interesimin e diasporës në zhvillimin ekonomik të vendlindjes, mund të ketë ndikim pozitiv përmes investimeve dhe remitancave;
- Mundëson që minoritetet të cilat janë banorë jashtë vendit të marrin pjesë në jetën politike;
- Ofron mundësi për të zhvendosurit dhe migrantët për të votuar, përfshirë edhe shërbyesit civil, shërbyesit diplomatikë;
- Zgjeron preferencat dhe interesat politike;



KUNDËR



- Qytetarët jo-rezident janë më pak të prekur nga veprimet e organeve/autoriteteve qeveritare;
- Qytetarët jo-rezident janë më pak të interesuar, dhe kanë më pak njohuri për problemet e shtetit;
- Nuk është praktike për kandidatët apo platformat të merren me çështje që kanë të bëjnë me votuesit jashtë vendit;
- Qytetarët jo-rezident nuk paguajnë taksa në vendlindje, përse të ketë të drejtë për të vendosur për çështje politike;
- Kostoja e organizimit të votimit jashtë vendit është shumë e lartë, 3 deri 4 herë më e lartë se votimi i zakonshëm;
- Ka mungesë transparence në votim, mund të shfaqen tendenca për mashtrim në zgjedhje;
- Disa qytetarë mund të kenë fituar tashmë të drejtën për të votuar në shtetin në të cilin banojnë;

Diaspora në Kosovë

Në dekadat e fundit, ka pasur disa valë të migrimeve të popullatës së Kosovës. Arsyet kryesore të migrimit përfshijnë, por nuk kufizohen në: (a) kërkim për azil; (b) ikje si refugjatë gjatë luftës; (c) kërkim të mundësive më të mira për punësim; (d) kërkim për edukim më të mirë apo mbështetje për nevoja shëndetësore; dhe (e) bashkim familjar.

Qytetarët lëvizin nga shtetet e tyre në baza ditore dhe shumë shtete sot ballafaqohen me sfidën e mbajtjes së një regjistri të qytetarëve të cilët jetojnë jashtë vendit, apo edhe mbikëqyrjen e lëvizjes së qytetarëve. Edhe Kosova ballafaqohet me këto probleme, pasi që nuk ka regjistër të qytetarëve që jetojnë jashtë apo mekanizma që përcjellin lëvizjen e qytetarëve. Për këtë arsye, Ministria e Diasporës në bazë të strategjisë dhe vendimeve të saj, ka filluar procesin e regjistrimit të qytetarëve të diasporës.

Burime të ndryshme dëshmojnë se jashtë vendit jetojnë diku në mes të 400.000 dhe 600.000 qytetarë të Kosovës¹. Kosova konsiderohet si shtet me diasporë të madhe në proporcion me numrin e përgjithshëm e qytetarëve vendas. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë, mbi 35% e emigranteve janë të vendosur në Gjermani, 23% në Zvicër, dhe mbi 7% në Itali. Shtetet tjera, duke përfshirë Kanadën dhe Australinë, përbëjnë mbi 10% të popullatës së emigrantëve kosovarë. Komunitet me numrin më të madh të emigrantëve janë: Prishtina, Gjakova, Mitrovica, dhe Suhareka, të cilat kanë mbi 25.000 emigrantë.²

Korniza ligjore mbi votimin jashtë Kosovës

Janë disa ligje që mbulojnë pjesë të ndryshme të procesit të votimit jashtë Kosovës: shtetësia, regjistrimi, e drejta e votës, metodat dhe procedurat e votimit.

Neni 2 i Ligjit për Shtetësinë, përkufizon Pjesëtarin e Diasporës si “çdo person që e ka qëndrimin e ligjshëm jashtë Republikës së Kosovës i cili dëshmon se ka lindur në Republikën e Kosovës, pjesëtar i diasporës konsiderohet edhe secili person i cili është pasardhës brenda një gjenerate i personit që ka lindur në Republikën e Kosovës”.³

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës⁴, Neni 5, thekson që çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese:

- është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;
- banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998⁵;
- ka fituar statusin e refugjatit.⁶


Kapitulli XIV i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës thekson se votuesi mund të votojë nga jashtë nëse ai/ajo ka kryer me sukses aplikimin për votim nga jashtë, duke ia dorëzuar formularin e aplikimit KQZ-së me postë apo me faks. KQZ shqyrton nëse votuesi ka të drejtë të votojë dhe i informon qytetarët mbi pranimin apo refuzimin e aplikacioneve. Qytetarit të cilët iu është refuzuar aplikacioni për votim jashtë vendit, i lejohet që të apelojë vendimin e KQZ në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

VOTIMI NGA JASHTË KORNIZA LIGJORE

Ligji për Diasporën
dhe Mërgatën
04/L-095

Ligji për Zgjedhjet
e Përgjithshme në
Republikën e Kosovës
03/L-073

Ligji për Librin
Amzë 2004/46



Ligji për Shtetësinë e
Kosovës 04/L-215

Rregullat e KQZ-së
mbi Votimin Jashtë
Kosovës 03/2013

KORNIZA LIGJORE

Ligji për Gjendjen
Civile 04/L-003

Procedurat për votim nga jashtë

Në mënyrë që të votojë nga jashtë, qytetari duhet që me sukses të aplikojë duke ia paraqitur formularin e regjistrimit Komisionit Qendror Zgjedhor, brenda afatit të regjistrimit. Regjistrimi për votim jashtë vendit mund të zgjasë deri 40 ditë gjatë zgjedhjeve të rregullta dhe mund të shkurohet deri në shtatë (7) ditë gjatë zgjedhjeve të parakohshme apo atyre të jashtëzakonshme. KQZ shqyrton të gjitha aplikacionet për të përcaktuar të drejtën e aplikuesve për votim. Atyre të cilëve iu është miratuar aftësia votuese, KQZ-ja iu dërgon me postë një zarf që përmban zarfin e fshehtësisë, një fletëvotim të paplotësuar dhe listën e kandidatëve, udhëzimet mbi mënyrën e votimit si dhe adresën e KQZ ku votuesit duhet ta kthejnë zarfin me fletëvotim. Votimi jashtë vendit në Republikën e Kosovës është i mundur vetëm përmes postës.

Në vitet e fundit, Komisioni Qendror Zgjedhor ndër-mori disa hapa të rëndësishëm me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së votuesve nga jashtë. Në korrik 2013, KQZ-ja miratoi një rregull të re për votimin jashtë vendit ku përfshihen procedurat për votim nga jashtë. KQZ-ja bashkëpunon me misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës për të shpërndarë formularë të aplikimit dhe udhëzime për qytetarët. KQZ gjithashtu ndërmerr fushata për informim të votuesve duke targetuar votuesit jashtë vendit, si shembull mund të merren edhe fletushkat informuese në Aeroportin e Prishtinës, që njoftojnë votuesit mbi procedurat e votimit përderisa ata largohen nga Kosova. KQZ-ja iu ka mundësuar votuesve përdorimin e metodave elektronike për aplikim dhe regjistrim. Tani votuesit mund të dorëzojnë formularët e regjistrimit përmes e-mailit në KQZ. Ata gjithashtu kanë qasje të lehtë në fletëvotime dhe broshura të kandidatëve, pasi që janë të disponueshme në ueb faqen e KQZ. Votuesit gjithashtu mund t'i printojnë fletëvotimet nga shtëpitë e tyre (edhe format A4, bardhë dhe zi), kështu që nuk kanë nevojë që të presin fletëvotimin origjinal që vjen me postë.

Pjesëmarrja e diasporës në procesin zgjedhor në Kosovë

Përgjatë viteve, ka pasur një ngritje të interesimit të diasporës për të votuar në Kosovë. Në shtetet ku ka numër të madh të kosovarëve (Austri, Gjermani, Zvicër, Mbretëri e Bashkuar dhe SHBA), ka pasur rritje të konsiderueshme të aplikimeve prej zgjedhjeve të vitit 2009 deri në ato të vitit 2017. Numri i aplikacioneve nga Serbia është rritur në mënyrë drastike në zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014, por kjo ka qenë si rezultat i grumbullimit të organizuar të aplikacioneve - proces që është lehtësuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Natyrisht do të ishte më e volitshme që votuesit të kenë më shumë kohë për tu regjistruar, mirëpo në Kosovë periudha e shkurtër e regjistrimit nuk ka treguar se ndikon në uljen e numrit të aplikacioneve-përkundrazi - në zgjedhjet e përgjithshme 2014 dhe 2017, kur afatet kanë qenë shumë më të shkurta, ka pasur numër më të madh të aplikacioneve të paraqitura . Në mënyrë progresive është ngritur kualiteti i aplikacioneve nga jashtë që mund të vërehet në ngritjen e përqindjes së aplikacioneve të aprovuara, që në zgjedhjet lokale 2017 ishte 89%.

Figura 1

Numri i aplikacioneve të pranuar për votim jashtë Kosovës prej 2009 deri 2017, sipas shteteve nga të cilat kanë ardhur










Shteti		Lokale 2009	Nacionale 2010	Lokale 2013	Nacionale 2014	Lokale 2017	Nacionale 2017
Austria		49	71	103	234	853	1,046
Gjermania		359	296	462	1,268	4,340	1,509
Mali i Zi		493	3,422	1,074	623	659	827
Serbia		81	485	38,228	25,433	4,395	4,076
Zvicra		627	288	878	1,307	5,432	2,361
Mbretëria e Bashkuar		2	39	32	99	422	102
Shtetet e Bashkuara të Amerikës		1	33	32	136	498	109
Të tjera		194	381	359	645	3,755	1,783
TOTAL		1.806	5.015	41.168	29.745	20,354	11,815


Figura 2 Të dhënat e procesit të votimit jashtë vendit, prej 2009 deri 2017



Shteti	Lokale 2009	Nacionale 2010	Lokale 2013	Nacionale 2014	Nacionale 2017	Lokale 2017
Afati i regjistrimit	40 ditë	N/A	N/A	7 ditë	7 ditë	40 ditë
Nr. i aplikacioneve të pranuara	1,806	5,015	41,168	29,745	20,354	11,815
Nr. i aplikacioneve të aprovuara (%)	n/a	1.640 (32%)	13.653 (33%)	16.569 (55%)	15,118 (74%)	10,487 (89%)
Nr. i shteteve nga kanë ardhur aplikacionet	n/a	32	29	40	59	40

Pengesat në pjesëmarrjen e diasporës në zgjedhje

Edhe pse nuk është bërë hulumtim i veçantë për të identifikuar barrierat që qytetarët jashtë vendit i hasin për të votuar nga jashtë, ato nuk janë edhe aq të padukshme. Interesimi i ulët i diasporës për të votuar mund të jetë shkak i arsyeve politike, ekonomike mirëpo edhe procedurale. Më poshtë janë një listë e barrierave të votimit, disa prej të cilave janë përmendur edhe në konsultime publike me diasporën gjatë verës së vitit 2018:



1

MUNGESA E DOKUMENTEVE TË IDENTIFIKIMIT:

Disa votues të diasporës mund ta kenë marrë shtetësinë dhe dokumentet e identifikimit në vendet ku banojnë dhe si rezultat ata nuk kanë marrë apo nuk kanë përditësuar dokumentet e identifikimit të Kosovës. Mund të ketë edhe prej atyre të cilët janë të motivuar të votojnë, por nuk kanë qenë një kohë të gjatë në Kosovë dhe në mungesë të dokumenteve nuk arrijnë të dëshmojnë kriteret e zotësisë juridike për të votuar. Deri më tani, procedurat e regjistrimit në Kosovë kanë qenë mjaft të vështira, gjë që ka mundur të shkaktojë hezitim në mes të pjesëtarëve të diasporës për regjistrim apo përditësim të dokumenteve të identifikimit. Disa pjesëtarë të diasporës gjithashtu kanë tërhequr shtetësinë e Kosovës, për të fituar shtetësin e vendit ku banon, kjo është vërejtur në përgjigjet e disa pjesëtarëve të cilët janë në Gjermani.

2

MUNGESA E NJOHURIVE PËR TË DREJTAT ZGJEDHORE:

Mund të ketë shumë qytetarë jashtë vendit të cilët nuk kanë dijeni për të drejtat e tyre të zgjedhjeve në Kosovë, kjo përfshin të drejtën për t'u regjistruar në regjistrin civil, të drejtën për t'u kandiduar, të drejtën për të votuar apo të drejtën për të bërë ankesa/apele. Qytetarët që nuk janë të njoftuar për të drejtat e tyre vështirë që do të mund të marrin pjesë në proces zgjedhor.

3

PËRFAQËSIMI I DOBËT I INTERESAVE TË DIASPORËS:

Problemet e shumta brenda vendit garojnë për vëmendje nga politikanët dhe diaspora zakonisht nuk arrin të jetë në mesin e prioriteteve më të larta. Interesat e qytetarëve brenda vendit mbasin primare dhe diaspora nuk arrin të përfaqësohet kënaqshëm. Gjithashtu, shumë prej qytetarëve jashtë vendit mund të jenë të zhgënjyer me situatën politike dhe ekonomike në vend dhe mund të ndihen të pamotivuar për të votuar. Mungesa e motivit është edhe e arsyeshme duka pasur parasysh që pjesëtarët e diasporë paguajnë taksa në vendet tjera dhe ndikohen më shumë nga vendimet e politikanëve të vendeve ku jetojnë.

4

MUNGESA E NJOHURIVE PËR PROCEDURAT TË VOTIMIT:

Procedurat e votimit jashtë vendit janë të komplikuar. Votuesit mund të mos jenë në dijeni për afatet kohore të aplikimit, mënyrën e aplikimit, dokumentet që nevojiten për të votuar, si plotësohet fletëvotimi, ku duhet të dërgohet, si të futet fletëvotimi brenda zarfit të fshehtë. Gjithashtu, mungesa e dijes për procedura të votimit mund të ndikojë negativisht në besimin që ata e kanë në procesin zgjedhor, dhe ata mund të vënë në pikëpyetje nëse votat e tyre numërohen, dhe se si ato kalkulohen me rezultatet e votave brenda vendit.

5

TARGETIMI I DOBËT I QYTETARËVE JASHTË VENDIT:

Subjektet politike nuk mund të bëjnë fushata jashtë vendit, prandaj targetimi i qytetarëve jashtë vendit është më i dobët. Edhe sikur fushatat jashtë shtetit të lejoheshin, procesi i targetimit të diasporës do të ishte shumë sfidues dhe i shtrenjtë. Si pasojë, çështjet që i përkasin qytetarëve jashtë vendit humbin prioritetin në programet dhe aktivitetet e subjekteve politike.

6


KOSTOJA E APLIKIMIT DHE VOTIMIT:

Votuesit mund të hezitojnë të ushtrtojnë të drejtën e tyre nëse votimi paraqet barrë financiare dhe kohore për ata. Votimi me postë kërkon nga votuesit që të paguajnë për shërbime postale gjatë aplikimit dhe dërgimit të fletëvotimit. Tërë kësaj i shtohet edhe kostoja kohore për të dërguar zarfin në zyret postale, kostoja e zarfëve dhe printimit të dokumenteve. Këto mund të jenë pengesa të mëdha, sidomos kur shoqërohen me motivimin e ultë për të votuar.

7

SFIDAT PROCEDURALE E APLIKIMIT/VOTIMIT:

Procedurat e votimit me postë duken burokratike që mund të dekurajojnë një pjesë të votuesve potencial. Së pari, votuesve u kërkohet që të aplikojnë për të votuar nga jashtë, të plotësojnë formularët, të skenojnë formularët, të bashkangjesin kopje të ndonjë dokumenti identifikimit dhe t'i dërgojnë ato në KQZ. Nëse aplikacioni i tyre aprovohet, atyre iu kërkohet që të printojnë fletëvotimin, të kenë me vetë zarf për të futur fletëvotimin, dhe ta dërgojnë atë në kutinë postare të KQZ.



8

AFATI I SHKURTËR PËR APLIKIM/REGJISTRIMIN:

Gjatë zgjedhjeve të rregullta votuesit mund t'i dërgojnë aplikacionet për regjistrim mes periudhës, jo më herët se 25 ditë nga shpallja e zgjedhjeve dhe jo më vonë se 60 ditë para ditës së zgjedhjeve. Megjithatë, ky afat kohor shpeshherë është shkurtuar deri në 7-10 ditë për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Kosovë. Afati i ngushtë nuk i jep hapësirë të duhur qytetarëve për të aplikuar në mënyrë të suksesshme për të votuar nga jashtë.

Ka disa metoda të cilat shtetet i përdorin për organizimin e zgjedhjeve jashtë vendit, duke përfshirë votimin: fizik (në ambasada apo konsullata), me postë, me faks, votimin elektronik, nëpërmjet një personi tjetër dhe votimin e parakohshëm (para ditës së zgjedhjeve).



II. VOTIMI JASHTË VENDIT: ANALIZA KRAHASIMORE

Votimi jashtë vendit dallon prej shtetit në shtet. Fillimisht, ka praktika të ndryshme në kuptim të llojit të zgjedhjeve për të cilat qytetarët jashtë shtetit kanë të drejtë votimi. Së dyti, ka dallime sa i përket metodave të votimit – përderisa disa shtete ofrojnë një mënyrë të votimit (personalisht ose përmes postës), shtetet ofrojnë mundësi të shumta të votimit, ose përdorin metoda elektronike inovative për t’ua mundësuar votimin qytetarëve jashtë vendit. Metodatat që shtetet i përdorin varen më së shumti nga resurset dhe kapacitetet që i posedon shteti për ta mundësuar votimin jashtë vendit. Së treti, shtetet kanë dallim në formulën që ato përdorin për të llogaritur se si përkthehen votat jashtë shtetit në ulëse në legjislativ. Në disa shtete, votat e marra nga votuesit jashtë vendit grumbullohen me votat e qytetarëve banorë të shtetit në një zonë elektorale të vetme, përderisa në disa shtete, ekziston një numër i veçantë i ulëseve në legjislativ që janë të rezervuara për përfaqësim të votuesve jashtë vendit. Së fundi, ka dallim në kriteret e të drejtës së votimit – përderisa disa shtete lejojnë të gjithë qytetarët të votojnë, ka edhe prej tyre që kufizojnë votimin vetëm për shërbyesit publikë jashtë vendit, ose bazuar në kohën e qëndrimit të qytetarit jashtë vendit.

Më poshtë, paraqesim disa krahasime me vende të tjera. Vlen të theksohet se për të plotësuar këto tabela janë përdorur dy burime kryesore: (1) Databaza e International IDEA për votim jashtë vendit dhe (2)

Raporti i Komisionit të Venedikut (2011) mbi votimin jashtë vendit. Meqenëse disa prej të dhënave nga këto dy burime nuk kanë qenë të përditësuara, janë përdorur edhe mjete tjera për të plotësuar figurat siç janë ligjet zgjedhore të këtyre shteteve, uebfaqet e trupave menaxhuese të zgjedhjeve, dhe materiale të tjera.

Lloji i zgjedhjeve për të cilat lejohet votimi nga jashtë

Disa shtete (Finlanda, Polonia dhe Zvicra) lejojnë votuesit nga jashtë të votojnë në të gjitha llojet e zgjedhjeve, përfshirë zgjedhjet në nivel kombëtar, nivel rajonal/lokal si dhe në referendume. Sidoqoftë, në disa shtete (Armenia, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Franca, Italia dhe Portugalia, Zelanda e Re) votimi prej jashtë vendit nuk lejohet për zgjedhje të nivelit rajonal/lokal. Kosova e lejon votimin nga diaspora për të gjitha llojet e zgjedhjeve .

Figura 3

Votimi i qytetarëve jashtë vendit sipas llojeve të zgjedhjeve



VOTIMI JASHTË
VENDIT I LEJUAR



NUK KA ZGJEDHJE TË
TILLA NË KËTË SHTET

Shteti	Presidenciale	Nacionale	Rajonale/ Lokale	Referendum
Armenia		✓		✓
Algjeria	✓	✓		✓
Belgjika	N/A	✓		
Bullgaria	✓	✓		
Kroacia	✓	✓		
Estonia	N/A	✓		✓
Finlanda	✓	✓	✓	✓
Franca	✓	✓		✓
Italia	N/A	✓		✓
Zelanda e Re	N/A	✓		✓
Portugalia	✓	✓		✓
Polonia	✓	✓	✓	✓
Zvicra	N/A	✓	✓	✓
Kosova	N/A	✓	✓	✓

KONKLUZAT NGA KONSULTIMET:

Në përgjithësi, ka pasur dy konkluzë kryesore nga fokus grupi dhe diskutimi publik: E para, Kosova duhet të vazhdojë të lejojë votimin jashtë vendit në zgjedhjet në nivel kombëtar. Në këto zgjedhje, ka shumë çështje të mëdha të politikave shtetërore që prekin interesat e diasporës siç janë zhvillimi

ekonomik, siguria shtetërore, politika e jashtme. Diaspora duhet të ketë qasje në vendimmarrje mbi këto çështje.

E dyta, përderisa disa pjesëmarrës në konsultime publike ishin të mendimit që votimi nga jashtë të hiqen për zgjedhjet lokale, shumica e pjesëtarëve

të diasporës në konsultime ishin më të interesuar për zgjedhjet komunale se sa ato qendrore. Kjo për shkak që diaspora edhe pse jeton jashtë, është prapë e afektuar nga çështjet e qeverisjes lokale siç janë rrugët lokale, shërbimet lokale shëndetësore, pronave me të cilat përballohen gjatë qëndrimit në Kosovë.

Mënyra e votimit

Ka disa metoda të cilat shtetet i përdorin për organizimin e zgjedhjeve jashtë vendit, duke përfshirë votimin: fizik (në ambasada apo konsullata), me postë, me faks, votimin elektronik, nëpërmjet një personi tjetër dhe votimin e parakohshëm (para ditës së zgjedhjeve). Secila nga këto metoda është unike në mënyrën e vet dhe kanë përparësitë dhe mangësitë e veta sa i përket respektimit të standardeve të zgjedhjeve, dhe gjithashtu barrës administrative përfshirë këtu planifikimin, logjistikën dhe buxhetin.

Në disa shtete aplikohet vetëm një mënyrë e voti-

mit si: votimi fizik (Bullgari, Kroaci) ose votimi me postë (Itali dhe Kosovë). Në shtete tjera përdoren disa mënyra për votim jashtë vendit me qëllim të nxitjes së daljes në votim si: votimi fizik, me postë dhe faks (Zelanda e Re). Shtetet tjera kanë hulumtuar mënyra më inovative duke përdorur votimin me internet (Zvicra, dhe Armenia për shërbimin diplomatik) . Ofrimi i mënyrave të ndryshme të votimit i mundëson votuesve qasje më të lehtë në votim, por shteti duhet të gjejë një balansin në mes dhënies të së drejtës së votimit në njërën anë, dhe planifikimit logjistik/operacional dhe kostos për implementim, në anën tjetër. Në Kosovë, votimi jashtë vendit është i mundur vetëm me anë të postës.

Figura 4

Praktikat sipas metodave të votimit

✓ = PËRDOR KËTË METODË SË VOTIMIT NË VOTIM JASHTË VENDIT



Shteti	Fizik	Me postë	Faks	E-votimi	Proxy
Armenia				✓	
Algjeria	✓				✓
Belgjika	✓	✓			✓
Bullgaria	✓				
Kroacia	✓				
Estonia	✓	✓			
Finlanda	✓				
Franca	✓	✓			✓
Italia		✓			
Zelanda e Re	✓	✓	✓		
Portugalia	✓	✓			
Polonia	✓	✓			
Zvicra	✓	✓		✓	

Kosova



KONKLUZAT NGA KONSULTIMET:

Gjatë konsultimeve janë shqyrtuar përparësitë dhe mangësitë e secilës metodë për votim jashtë vendit. Votimi përmes postës është metodë e lehtë për t'u zbatuar dhe më e qasshme për votuesit, mirëpo në anën tjetër është metodë e pakontrollueshme pasi që trupat menaxhuese të zgjedhjeve nuk mund të vëzhgojnë se kush aplikon për të votuar, apo voton, përderisa respektohen të gjitha procedurat dhe afatet kohore të votimit. Konkluzat kryesore dhe pothuajse e pakontestueshme nga diskutimet publike ishte se Kosova ka kapacitetet për

të implementuar edhe votimin fizik, për të komplementuar votimin përmes postës, në mënyrë që të nxis pjesëmarrje më të lartë të diasporës në zgjedhje përmes përdorimit të metodave të shumëllojshme.

Metoda e votimit fizik mund të zbatohet me procedura të njëjta të votimit duke hapur qendra të votimit nëpër misionet diplomatike dhe konsulore të Kosovës. Kjo do t'u mundësonte votuesve të diasporës që gjenden afër ndonjë ambasade apo konsulate të votojnë fizikisht sikur të jenë brenda shtetit, pa pasur nevojë që

të hyjnë nëpër procedurat e regjistrimit, dërgimit të postës dhe proceseve të tjera. Nëse kjo metodë aplikohet në Kosovë në të ardhmen, do të ishte mirë të fillojë së pari me një pilot projekt në konsullatat dhe ambasadat e Kosovës në Gjermani apo Zvicër, përreth së cilës ka qytetarë të interesuar për të votuar. Pilot-projekti do të mundësonte Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të testojë këtë metodë të votimit, të marrë mësimet e nxëna nga implementimi dhe pastaj të vendos nëse dëshiron të implementojë votimin fizik edhe në vende tjera.

Mënyra e përfaqësimit

Në shumicën e vendeve ku lejohet votimi jashtë vendit nuk ka forma të rezervuara të përfaqësimit të diasporës në legjislativ. Votat jashtë vendit bashkohen me votat në ditën e votimit brenda vendit dhe konsiderohen si vota të zakonshme brenda vendit. Për shkak që dalja e votuesve jashtë vendit është gjithmonë dukshëm më e ulët se e atyre brenda vendit, preferencat e votuesve që votojnë brenda shtetit zakonisht kanë më shumë peshë (për shkak të numrit më të madh të votuesve) se e atyre që votojnë jashtë vendit. Për të siguruar një balansim në përfaqësim të interesave të votuesve jashtë vendit, disa shtete kanë paraparë ulëse të rezervuara në legjislativ për votuesit jashtë vendit.

Ulëset e rezervuara janë të rregulluara dhe funksionojnë në mënyra të ndryshme. Përderisa ndarja e ulëseve zakonisht rregullohet me ligj, në Itali, marrim shembull, përfaqësimi i diasporës është garantuar me Kushtetutë (Neni 56 dhe 56). Në Francë, ka ekzistuar një traditë e përfaqësimit të votuesve jashtë

vendit në Senat, mirëpo së fundi (2012) janë paraparë ulëse të rezervuara për diasporë edhe në Asambledë Kombëtare. Në Portugali, katër (4) ulëse për diasporë në legjislativ janë të zgjedhura me votim nga dy zona elektorale: 1) votuesit në Evropë; dhe 2) pjesa tjetër e botës. Në Ekuador, janë tri zona zgjedhore me nga dy ulëse në secilën, për përfaqësim të ekuatorianëve jashtë vendit. Në Kroaci, numri i ulëseve të rezervuara për diasporën varet nga numri i votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje, por diaspora nuk mund të ketë më shumë se gjashtë ulëse në Parlamentin e Kroacisë.

Proporcioni i ulëseve të rezervuara për votuesit jashtë vendit në legjislativ në të gjitha këto shtete është në mes 1% dhe 5%. Kosova nuk ka vende të rezervuara për diasporë as në nivel qendror e as në lokal. Megjithatë, në Kosovë ideja e ulëseve të rezervuara nuk është gjë e re, meqenëse ka njëzet ulëse të rezervuara për përfaqësim të minoriteteve dhe aplikohet kuota gjinore prej 30% për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinorë në legjislativ.



Figura 5

Shtetet me ulëse të garantuara për përfaqësim të diasporës

Shteti	Parlamenti (numri i ulëseve)	Numri (%) e ulëseve për diasporë
Algjeria	Asambleja Nacionale e Popullit (462 ulëse) Këshilli i Shteteve (144 ulëse)	8 nga 462 ulëse (1.7%) në Asamblenë Nacionale;
Kroacia	Parlamenti Kroat (151 ulëse)	3 nga 151 ulëse (1.9%) në Parlamentin Kroat
Italia	Dhoma e Deputetëve (630 ulëse) Senati i Republikës (322 ulëse)	12 nga 630 ulëse (1.9%) në Dhomën e Deputetëve; 6 nga 322 ulëse (1.9%) në Senat
Franca	Senati (348 ulëse) Asambleja Nacionale (577 ulëse)	12 nga 348 ulëse (3.6%) në Senat; 11 nga 577 ulëse (1.9%) në Asamblenë Nacionale
Portugalia	Asambleja e Republikës (230 ulëse)	4 nga 230 ulëse (1.7%) në Asamblenë e Republikës
Maqedonia	Kuvendi i Republikës (123 ulëse)	Ka pas 3 nga 123 ulëse (2.4%) në Kuvend në mandatin e kaluar
Ekuador	Asambleja Nacionale (137 ulëse)	6 nga 137 ulëse (4.4%) në Asamblenë Nacionale
Kolumbia	Senati (102 ulëse) Shtëpia e Përfaqësuesve (166 ulëse)	2 nga 166 ulëse (1.2%) në House of Representatives
Kosova	Kuvendi i Kosovës (120 ulëse)	Nuk ka ulëse për përfaqësim të diasporës

VOTIMI NGA JASHTË VENDIT

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë për Mërgatën dhe Diasporën, në konsultimet publike, Ministria e Diasporës kishte hasur në një disponim publik që diaspora të ketë ulëse të rezervuara në Kuvendin e Kosovës, mirëpo “aktualisht, mundësia e insti-

tucioneve kosovare për t’iu përgjigjur plotësimit të këtyre kërkesave mbetet e paktë, për faktin se një gjë e tillë ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila nuk mund të bëhet në një periudhë afatmesme”.⁷

KONKLUZAT NGA KONSULTIMET:

Edhe pse kishte pjesëmarrës që mbështetin idenë e ulëseve të rezervuara, në përgjithësi, kishte konsensus se përfaqësimi i diasporës përmes ulëseve të rezervuara nuk është një

praktikë që Kosova mund ta ndjekë në periudhë afatshkurtër. Disa prej pjesëmarrësve nga diaspora që partitë politike të integrojnë në programet e tyre çështjet që kanë të bëjnë me

diasporën, dhe/ose të nominojnë kandidatë brenda listës që vijnë nga diaspora, apo që përfaqësojnë interesat e diasporës.

Kriteret për të drejtën e votimit jashtë vendit

Shumica e shteteve që lejojnë votimin jashtë vendit zakonisht i lejojnë të gjithë votuesit e regjistruar të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeçare që të votojnë. Kjo praktikë ndjeket nga disa shtete (Bullgari, Kroaci, Estoni, Finlandë, Francë, Itali, Portugali, dhe Poloni). Disa shtete (Armenia, Izraeli, dhe Irlanda) i japin të drejtën e votimit vetëm atyre që shërbejnë në misione diplomatike apo konsulare. Në Zelandë të Re, vetëm qytetarët të cilët kanë qenë aty të paktën njëherë brenda tre vjetëve të fundit mund të votojnë nga jashtë .

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë për Mërgatën dhe Diasporën, në konsultimet publike, Ministria e Diasporës kishte hasur në një disponim publik që diaspora të ketë ulëse të rezervuara në Kuvendin e Kosovës, mirëpo “aktualisht, mundësia e institucioneve kosovare për t’iu përgjigjur plotësimit të këtyre kërkesave mbetet e paktë, për faktin se një gjë e tillë ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila nuk mund të bëhet në një periudhë afatmesme” .

KONKLUZAT NGA KONSULTIMET:









Pjesëmarrësit ishin të pajtimit që të gjithë qytetarët me të drejtë vote të

vazhdojnë të kenë të drejtë të votimit nga jashtë vendit, dhe mos të ketë

kufizime siç është praktika në disa shtete të caktuara.

Figura 8

Praktikat bazuar në atë se kujt i lejohet e drejta për të votuar jashtë vendit

Shteti	Të gjithë votuesve	Kufizimet
Armenia		Vetëm shërbyesit civil në shërbime diplomatike dhe konsulare, dhe anëtarët e tyre të familjes mund të votojnë.
Bullgaria		
Kroacia		
Estonia		
Finlanda		
Franca		
Izraeli		Vetëm personat që shërbejnë jashtë vendit në detyra zyrtare mund të votojnë.
Italia		
Irlanda		Vetëm zyrtarët publik Irlandez jashtë vendit dhe pjesëtarët e forcave të armatosura
Zelanda e Re		Vetëm qytetarët të cilët kanë qenë në Zelandë të Re brenda tre vjetëve mund të votojnë.
Portugalia		
Polonia		
Kosova		

III. KONSULTIMET PËR VOTIM NGA JASHTË VENDIT PËR KOSOVË

Gjatë muajit korrik/gusht 2018, Demokraci Plus (D+) ka mbajtur tri konsultime publike me pjesëtarë të diasporës për të diskutuar tema në lidhje me votimin nga jashtë.

Konsultim publik me pjesëtarë të diasporës në Kamenicë: Një takim konsultues është mbajtur në Kamenicë më 27 korrik 2018, me pjesëtarë të diasporës nga Austria, Gjermania dhe Zvicra. Në takim konsultues ishin 20 pjesëmarrës, prej të cilëve 7 ishin gra. Në takim kanë marrë pjesë edhe zyrtarët komunal të zgjedhjeve të komunave të Kamenicës dhe Gjilanit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Konsultim publik me pjesëtarë të diasporës në Mitrovicë: Një takim konsultues është mbajtur edhe në Mitrovicë më 31 korrik 2018. Në këtë takim kanë marrë pjesë 19 pjesëmarrës, prej të cilëve 12 ishin gra. Në takim ka marrë pjesë edhe zyrtari komunal i zgjedhjeve i KQZ-së në Mitrovicë. Pjesëtarët e diasporës në këtë konsultim kishin vendbanim në Gjermani.

Konsultim publik me pjesëtarë të diasporës në Gjakovë: Një takim konsultues është mbajtur në Gjakovë më 29 gusht 2018. Në këtë takim kanë marrë pjesë 11 pjesëmarrës, prej të cilëve gjashtë (6) ishin gra. Pjesëtarët e diasporës në këtë konsultim publik kishin vendbanim në Zvicër dhe Belgjikë.

IV. REKOMANDIMET PËR VOTIM JASHTË KOSOVËS

Në bazë të konsultimeve me pjesëtarët e diasporës, konsultimeve me përfaqësues të Komisionit Qendor të Zgjedhjeve dhe shqyrtimit të procedurave për votim jashtë vendit, Demokraci Plus nxjerr rekomandimet në vijim prej të cilave disa janë të zbatueshme me kornizën ligjore aktuale, e disa kërkojnë ndryshime të legjislacionit zgjedhor.

Rekomandimet e zbatueshme me kornizën ligjore aktuale

ZHVILLIMI I MODULIT ELEKTRONIK PËR APLIKIM: Përveç mundësisë aktuale që të aplikohet duke e plotësuar formën e aplikimit nga jashtë vendit dhe dorëzimit të formës në mënyrë manuale, rekomandohet të zhvillohet dhe të hyj në përdorim moduli elektronik në uebfaqen e Komisionit Qendor të Zgjedhjeve që mundëson aplikimin online (ueb-based). Kjo metodë ka disa përfitime: (1) mundëson që forma e aplikimit të jetë më e thjeshtëuar se sa forma manuale (shiko formën); (2) mënjanon gabimet në futjen e të dhënave në mënyrë manuale nga formularët; (3) mënjanon mbingarkesën e e-mailit zyrtar të KQZ-së që ka qenë problem në zgjedhjet e kaluara, dhe; (4) bën më të lehtë dhe qasshëm aplikimin për shkak që nuk ka nevojë për printim/plotësim të formularit.

THJESHTËSIMI I FORMULARIT PËR APLIKIM: “Formulari i Aplikimit për Votim Jashtë Kosovës” i KQZ-së mund të thjeshtësohet që të marr më pak kohë për të aplikuar. Në formularin më poshtë në këtë raport me “X” janë shënuar mbi kutitë të cilat jo domosdoshmërisht janë të nevojshme për t’u plotësuar. Rekomandohet që në formularë të kërkohe vetëm këto të dhëna: emri, mbiemri, numri personal (nëse ka ID të Kosovës), adresa e vendbanimit jashtë, informatat kontaktuese dhe nënshkrimi. Të dhënat nuk janë të nevojshme, për shkak që mund të verifikohen përmes futjes së numrit personal janë: data e lindjes, vendi i lindjes, emri i prindit, qyteti/komuna, dhe gjinia. Formulari gjithashtu duhet të vendoset në formatin Word, që të mundësoj plotësimin pa pas nevojë për të printuar/skanuar formularin. Mund të konsiderohet që krahas nënshkrimit fizik (nënshkruar me kimik), të filloj edhe përdorimi i nënshkrimit elektronik.

VOTIMI NGA JASHTË VENDIT

I. TË DHËNAT PERSONALE/LIÇNI PODACI			
1. Mbiemri / Prezime	<input type="text"/>	2. Emri / Ime	<input type="text"/>
3. Emri i prindit / Ime roditelje	<input type="text"/>	4. Data e lindjes / Datum roditelje	<input type="text"/> / <input type="text"/> / <input type="text"/>
5. Vendi i lindjes / Mesto roditelje	<input type="text"/>	6. Qyteti / Komuna / Grad / Opština	<input type="text"/>
7. Numri personal / letërnjoftimit / Republikës së Kosovës / UNMIK - ut / Broj lična karta Republike Kosova / UNMIK-a	<input type="text"/>	8. Gjinia / Pol	<input type="text"/>

II. ADRESA E TASHME JASHTË KOSOVËS / SADAŠNJA ADRESA VAN KOSOVA

KOD IDENTIFIKUES PËR SHETASIT JASHTË VENDIT: Ministria e Punëve të Brendshme të bashkëpunoj me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të vendos një kod identifikues për shtetasit e Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit në regjistrin civil, sikurse që ekziston kodi për shtetasit që nxjerrin dokumente të Republikës së Kosovës në ambasada dhe konsullata jashtë vendit. Aktualisht nuk ka ndonjë regjistrë të qytetarëve të Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit. Regjistrin e Ministrisë së Diasporës nuk ka mbledhë të dhënat personale të qytetarëve jashtë vendit (si numrin personal), dhe si i tillë mund të shërbejë vetëm për çështje të hulumtimit dhe krahasimit të të dhënave. Prandaj është e nevojshme që në mënyrë afatgjatë dhe sistematike që përmes mekanizmave si (a) lajmërimi i adresës nga pjesëtarët e diasporës gjatë nxjerrjes së dokumenteve; (b) lajmërimi vullnetar i vendbanimit jashtë - përmes një fushate vetëdijësuese; (c) regjistrin të pjesëtarëve që nxjerrin dokumente jashtë vendit, dhe (d) krahasimit të të dhënave me regjistrin e Diasporës; të fillojë regjistrimi i qytetarëve jashtë vendit. Kjo mundëson zhvillimin e politikave më të mira nacionale për diasporën, përfshirë edhe në proceset zgjedhore, duke alokuar resurse të nevojshme për votim nga jashtë, dhe duke lehtësuar procesin e verifikimit të votuesve nga jashtë në listën e votuesve që është ekstrat i regjistrin civil.

DËRGIMI I ZARFEVE NË MËNYRË TË GRUMBULLUAR: Të vazhdojë të lejohet dërgimi i zarfeve me postë në mënyrë të grumbulluar. Për shembull, kur një familje prej pesë (5) anëtarëve dëshiron të votojë, të ju mundësohet që aplikacionet apo votat të i dërgojnë në KQZ me një zarf të madh ku do të futeshin zarfat më të vogël individual, dhe jo domosdoshmërisht në pesë (5) zarfe të veçanta, në mënyrë që të ulët kosto e votimit. Në këto raste, KQZ mund të konsideroj që të kërkojë dokumente shtesë të verifikimit, përveç dokumentit identifikues, edhe një dokument që vërteton adresën jashtë vendit për një prej familjarëve (si p.sh. certifikat vendbanimi, fatura e rrymës, ujit, internetit apo shërbimeve të tjera). Kjo për të mënjeluar rastet sikur sfidat në lidhje me votimin nga jashtë në Komunën e Istogut gjatë vitit 2017.

NGRITJA E CILËSISË SË EDUKIMIT DHE INFORMIMIT TË VOTUESVE: Në përgjithësi në takimet konsultuese pjesëtarët e diasporës theksuan se nuk kanë qenë të informuar për proceset zgjedhore, të drejtën e tyre për të votuar, procedurën e aplikimit apo të votimit. Për pjesëtarët e diasporës në takime konsultuese, burimet kryesore të informacionit për Kosovë ishin televizionet (RTK, KTV, Klan Kosova) dhe portalet online. Shumë prej tyre rekomanduan që informatat për zgjedhje të iu dërgohen përmes

postës. Për këtë arsye mund të përdoren adresat e regjistruara në regjistrin e Ministrisë së Diasporës dhe adresat që kanë në dispozicion ambasadat dhe konsulatat. Përveç këtyre, informimi duhet të jetë më i targetuar duke shfrytëzuar kapacitetet e ambasadave dhe konsulatave, Ministrisë së Diasporës, dhe shoqatave të diasporës jashtë vendit.

Rekomandimet e zbatueshme me ndryshime ligjore

DORËZIMI I APLIKACIONEVE/VOTAVE ME POSTË NË AMBASADA DHE KONSULATA TË KOSOVËS:

Ndryshimet ligjore mund të hapin rrugën që aplikacionet fizike dhe votimi të bëhet edhe përmes dorëzimit të postës në ambasada apo konsulata të Kosovës jashtë vendit. Në këtë rast shërbimi diplomatik do të shërbente si pikë grumbulluese për aplikacione dhe vota të cilat në mënyrë të grumbulluar pastaj do të dorëzoheshin në Komisionin Qendor të Zgjedhjeve. Për pjesëtarët e diasporës kjo metodë lehtëson procesin e votimit. E para, sipas tyre posta arrinë më shpejtë nëse dërgohet brenda shteteve ku ata jetojnë (Gjermani, Zvicër, Austri), zakonisht brenda 24 orësh në krahasim me 7 deri 10 ditë në Kosovë. E dyta, kushton shumë më lirë që postën ta dërgojnë për brenda se sa ta dërgojnë në Kosovë, përderisa barra e shpenzimit postar do të ishte në misionet diplomatike.

VOTIMI VETËM ME DOKUMENTE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS:

Me ndryshime ligjore, vetëm ata votues të cilët janë të pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës duhet të lejohen të votojnë nga jashtë. Aktualisht me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme parashihet që të drejtë vote të kenë edhe banorët jashtë Kosovës ose banorët që kanë lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që i plotësojnë kriteret për të qenë qytetar i Kosovës. Me rregulloren e KQZ-së për votim jashtë Kosovës parashihen një listë prej dhjetra dokumentash (që nuk janë të lëshuara nga Republika e Kosovës) që

aplikuesit mund t'i dorëzojnë për të fituar zotësinë juridike. Deri tani, për qëllim të verifikimit të së drejtës për të votuar, kjo dispozitë ligjore ka bërë që Komisioni Qendor të Zgjedhjeve dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa të ushtrojnë detyra për verifikimin e shtetësisë në prag të zgjedhjeve, duke ndërlikuar procesin e aplikimit nga jashtë. Aplikimi dhe votimi përmes këtyre dokumenteve gjithashtu ka ngritur pyetje rreth integritetit të procesit të votimit jashtë vendit, dhe fryerjes së listës së votuesve, veçanërisht për procesin e votimit të votuesve prej Serbisë.

ZGJATJA E AFATIT PËR PRANIM TË FLETËVOTIMIT:

Duke pas parasysh afatet e shkurtëra në rast të zgjedhjeve të jashtëzakonshme, supozimin që sistemi zgjedhor mbetet i njëjtë dhe se procedurat e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve mbeten të njëjta në raport me numërimin e votave nga jashtë, mund të konsiderohet zgjatja e afatit për pranimin e fletëvotimeve nga jashtë deri në 5 apo 7 ditë pas ditës së zgjedhjeve. Me rregulloren e KQZ-së është përcaktuar që fletëvotimi duhet të arrij në kutinë postare të KQZ-së të paktën 24 orë para ditës së zgjedhjeve.

VOTIMI FIZIK NË AMBASADA DHE KONSULATA:

Edhe pse për disa prej pjesëtarëve të diasporës në konsultime publike ambasadat apo konsulatat e Kosovës ishin deri në 300-400 kilometër distancë, shumica e pjesëtarëve të diasporës sugjeruan që të filloj votimi fizik në ambasada dhe konsulata, si metodë shitesë e votimit përveç asaj me postë. Sipas International IDEA (Voting from Abroad), votimi fizik praktikohet në mbi 50 shtete të botës. Organizimi i votimit fizik është i kushtueshëm, është sfidë operationale dhe teknike, dhe ngrit pyetje të integritetit të procesit zgjedhor mbi atë se kush ka të drejtë vote, kush i administron zgjedhjet dhe se a ka paanshmëri në ambasada dhe konsulata. Prandaj, nëse hapet rruga për votim fizik në ambasada, sugjerohet që të fillohet me një pilot projekt para se të shpërndahet në të gjitha shërbimet diplomatike.

V. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE MBI VOTIMIN JASHTË VENDIT

Përderisa instrumentet ligjore ndërkombëtare, siç janë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike garantojnë të drejtat e votimit dhe të drejtën universale të votës, ato nuk kanë dispozita që në mënyrë eksplicite drejtohen tek mundësimi i votimit për qytetarët që banojnë jashtë shtetit të tyre. Nuk ekzistojnë obligime ndërkombëtare që i detyrojnë shtetet të organizojnë votimin e qytetarëve jashtë vendit, dhe mbetet në diskrecion të shteteve të zgjedhin nëse dëshirojnë të lejojnë votimin jashtë vendit, ose si do ta zbatojnë këtë proces nëse e lejojnë.

Burimi i vetëm i të drejtës ndërkombëtare për të mbuluar votimin prej jashtë vendit në mënyrë eksplicite, është Konventa Mbrojtje të Drejtave të Punëtorëve Migrantë (1990). Kjo konventë është krijuar për të drejtën e punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, që të marrin pjesë në punët publike dhe të votojnë në zgjedhjet që mbahen në shtetin e tyre. Deri në ditët e sotme, kjo konventë është ratifikuar vetëm nga 47 shtete.

Janë edhe disa instrumente rajonale, që po ashtu garantojnë të drejta të votimit si: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve. Për më tepër, në vitin 2005, Këshilli i Evropës ka miratuar një rezolutë në heqjen e kufizimeve për të drejtën e votimit, duke inkurajuar shtetet anëtare për të lejuar votimin për banorët jashtë vendit, dhe për të zbuluar modalitete që ua lehtësojnë votimin qytetarëve të tyre. Për më shumë, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, deklaroi se votimi jashtë vendit mund të lejohet përderisa nuk shfaqë ndonjë rrezik të mashtrimit ose kërcënimi. Përgjithësisht, votimi prej jashtë vendit konsiderohet një proces i vështirë dhe sfidues, dhe nëse shtetet vendosin ta mbajnë, pritet që duhet t'i përmbushin disa standarde sikurse votimi brenda shtetit, në kuptim të transparencës, sigurimit dhe mbajtjes së fshehtë të votës.

Instrumenti Ndërkombëtar**Kufizimet****Deklarata Univerzale e të Drejtave të Njeriut**

(miratuar më 1948)

Neni 21:

1. Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirish.
2. Gjithkush ka njëlloj të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.
3. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike

(miratuar më 1966)

Neni 25:

Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

- (a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirish;
- (b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;
- (c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë

(miratuar më 1990)

Neni 41:

1. Punëtorët migrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre duhet të kenë të drejtën për të marrë pjesë në punët publike të shtetit të tyre, si dhe të votojnë dhe të zgjedhën në zgjedhjet e atij shteti, në pajtueshmëri me legjislacionin e tij.
2. Shtetet që kanë lidhje me këtë çështje, duhet në përputhje dhe në pajtueshmëri me legjislacionin e tyre të facilitojnë ushtrimin e këtyre të drejtave.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

(miratuar më 1950)

Neni 3: E drejta për zgjedhje të lira

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.

Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve

(miratuar më 1981)

Neni 13:

1. Çdo qytetar duhet të ketë të drejtën të marrë pjesë lirshëm në qeverinë e shtetit të tij, ose në mënyrë direkte, ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të lirë në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit.

Instrumenti Ndërkombëtar

Kufizimet

Komisioni i Venedikut,
Kodi i Praktikës së Mirë në
Çështjet Zgjedhore (miratuar
më 2002)

1. Votimi i përgjithshëm; 1.1. Rregulla dhe përjashtime; c; v.

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur mund t'i njihet edhe shtetasve që jetojnë jashtë vendit.

39. Megjithatë, duke marrë masat e duhura, votimi postar mund të përdoret për t'u dhënë mundësi pacientëve në spitale, personave që u është kufizuar liria për të lëvizur dhe zgjedhësve, që jetojnë jashtë vendit, për të votuar, me kusht që të mos ekzistojë rreziku i mashtrimit dhe friksimit

Asambleja Parlamentare
e Këshillit të Evropës,
Rezoluta 1459 për Heqjen e
Kufizimeve mbi të Drejtën e
Votimit

(miratuar më 2005)

7. Duke qenë se e drejta për të votuar është shumë e rëndësishme në një shoqëri demokratike, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës duhet t'ua mundësojnë qytetarëve të tyre që jetojnë jashtë vendit të votojnë gjatë zgjedhjeve kombëtare, duke pasur parasysh kompleksitetin e sistemeve të ndryshme elektorale.

Ata duhet të marrin masa të duhura për ta lehtësuar ushtrimin e të drejtave të tilla të votimit, sa më shumë që të munden, në veçanti duke konsideruar si opsion votimi përmes votës, votimin konsullor, ose atë përmes internetit, që duhet të jenë konsistente me Rekomandimet (2004)11 të Komisionit të Ministrave të shteteve anëtare për standardet teknike, ligjore dhe operative për votim elektronik.

Shtetet anëtare duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për këtë qëllim dhe t'i përmbahen vendosjes së pengesave të panevojshme në rrugën e ushtrimit efektiv të të drejtave për votim të shtetësve të huaj që banojnë në territoret e tyre.

BIBLIOGRAFIA

- 1 Forumi 2015 (2007) Diaspora dhe politikat e migracionit. Forumi 2015 (2007) Diaspora dhe politikat e migracionit. <http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/49.pdf> dhe Leon Malazogu (2015). Vendosija e drejtësisë në zgjedhje. <http://d4d-ks.org/assets/2015-07-10-Electoral-Justice-Report-ALB.pdf>
- 2 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2014) Migrimi në Kosovë. http://ask.rks-gov.net/publikimet/doc_doenload/1104-migrimi-kosovar
- 3 Kuvendi i Kosovës (2013) Ligji për shtetësinë e Kosovës. https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Ligji_per_Shtetesi_-_Shqip.pdf
- 4 Kuvendi i Kosovës (2010) Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë. <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-256-alb.pdf>
- 5 Me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo
- 6 Siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës;
- 7 Ministira e Diasporës (2013), Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018, Kapitulli XI

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

342.8

Votimi nga jashtë vendit : shqyrtimi i politikave dhe rekomandimeve praktike / punimi u përpilua nga Demokraci për Zhvillim dhe Demokraci Plus. – Prishtinë : Demokraci për Zhvillim, 2018. – 22 f : ilustr. ; 28 cm.

ISBN 978-9951-608-74-9



Ky hulumtim është realizuar në kuadër të projektit “Avancimi i proceseve demokratike”, i cili implementohet nga Demokraci për zhvillim (D4D), me përkrahje nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës,



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

dhe të, projektit “Rritja e pjesëmarrjes qytetare në proceset zgjedhore në Kosovë” në kuadër të Koalicionit për Integritet Zgjedhor (KIZ) financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**